





LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 3:	MASAT SPECIFIKE PARANDALUESE
Tema 3.2.	SHENJAT E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
Shkurtesa:	• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Nuk duhet ta përdorni këtë listë kontrolluese nëse kompania juaj operon në transport rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, detar ose ajror, sepse Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 nuk është e zbatueshme në ato industri.
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
.				
	INSPEKTIMI I LOKACIONEVE / VENDEVE TË PUNËS			
	* Bëhuni shembull, respektoni shenjat e sigurisë që ekzistojnë në lokacion/ vendet e punës! * Gjatë vizitës në lokacion / vendet e punës, tregoni vëmendje nëse shenjat e sigurisë janë të vendosura në vendet e punës dhe nëse të punësuarit u binden kërkesave (p.sh. përdorin pajisje personale mbrojtëse në përputhje me shenjat e detyrueshme). * Merrni shënime për vendet e punës të vëzhguara dhe bëni fotografi të vendosjes/mungesës së shenjave të sigurisë (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë). * Mbani mend: - o shenjat e sigurisë mund të përdoren së bashku dhe të kombinuara (p.sh. shenjat e ndriçimit të daljes emergjente)			

	○ duhet të shmanget vendosja e shumë shenjave shumë afër njëra tjetrës ○ numri dhe pozicionimi i shenjave ose pajisjeve sinjalizuese që duhet të instalohen varen nga shtrirja e rrezeqeve ose nga zona që do të mbulohet			
1.	A janë shënuar rrugët e daljes emergjente? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I Neni 2.1.1 <i>* Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për rrugët e daljes emergjente nga disa pika të lokacionit. Ecni nëpër 2-3 rrugë të daljes emergjente për të identifikuar nëse mund të arrini në një pikë të sigurt grumbullimi vetëm duke ndjekur shenjat e sigurisë. Në rrugën tuaj mund të kontrolloni edhe nëse rrugët e daljes janë të lira, mjaftueshëm të gjera, dyert nuk janë të kyçura ose bllokuara etj.</i>			
2.	A janë shënuar objektet e ndihmës së parë? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I Neni 2.1.1 <i>* Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni 2-3 punëtorë nëse e dinë ku ndodhen objektet e ndihmës së parë.</i>			
		Kuti e ndihmës së parë		

		<i>Lesë</i>			
		<i>Dushi i sigurisë</i>			
		<i>Pastrues për sy</i>			
		<i>Telefon emergjent për ndihmë të parë ose shpëtim</i>			
		<i>Këtej (shenjë informuese plotësuese) Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet e ndihmës së parë, ose pikat e tyre të qasjes.</i>			
3.	Tek pajisjet zjarrfikëse, a janë vendosur shënime të përherëshme me tabela dhe/ose ngjyra të sigurisë me të kuqe?				
	Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.2, Shtojca IV * Kontrolloni 2-3 vende me pajisje zjarrfikëse nëse këto vende janë shënuar.				


		<i>Tub zjarri</i>			
		<i>Shkallë</i>			
		<i>Fikës zjarri</i>			
		<i>Telefon emergjent për zjarr</i>			
		<i>Këtej (shenjë informuese plotësuese) Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet për zjarrfikje, ose pikat e tyre të qasjes.</i>			
4.	A është vendosur numër i mjaftueshëm i shenjave të ndalimit? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II * “Shenja e ndalimit” nënkupton një shenjë sigurie që ndalon sjelljen që ka të ngjarë të shkaktojë risk për shëndetin ose sigurinë. Një shenjë ndalimi tregon vetëm atë që është e ndaluar ose kush e ka të ndaluar. Në përgjithësi, shenjat e sigurisë për ndalimet përdorin një simbol të zi të sigurisë në një rreth të kuq me një vijë diagonale në mes. Shenja tipike e ndalimit është ndalimi i pirjes së duhanit				

	<i>në vende të caktuara të punës, ndalimi i qasjes për këmbësorët etj. Ndërkohë që ecni nëpër lokacion, tregoni vëmendje ndaj të gjitha vendeve ku duhet të vendosen shenja të tilla. Diskutoni me punëtorët se çfarë kuptimi kanë shenjat e sigurisë! Shembujt e shenjave jepen në fund të kësaj liste kontrolluese.</i>			
5.	A është vendosur numër i mjaftueshëm i shenjave paralajmëruese? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II <i>* “Shenja paralajmëruese” nënkupton një shenjë sigurie që tregon lokacionet ose situatat e rrezikshme. Këto shenja të shëndetit dhe sigurisë kërkohet të jenë të verdha. Shenja tipike paralajmëruese është shenja e dyshemesë së lagur që përdoret pas pastrimit të dyshemesë për t'i paralajmëruar njerëzit në lidhje me dyshemenë e lagur dhe për të parandaluar që ata të rrëshqasin dhe rrëzohen etj. Një shembull tjetër është shenja e sigurisë që specifikon rrezikun e energjisë elektrike. Ndërkohë që ecni nëpër lokacion, tregoni vëmendje ndaj të gjitha vendeve ku duhet të vendosen shenja të tilla. Diskutoni me punëtorët se çfarë kuptimi kanë shenjat e sigurisë! Shembujt e shenjave jepen në fund të kësaj liste kontrolluese.</i>			
6.	A është vendosur numër i mjaftueshëm i shenjave detyruese? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II <i>* “Shenja detyruese” nënkupton një shenjë që përshkruan sjelljen. Këto shenja kërkohet të jenë në ngjyrë të kaltër. Një shenjë detyruese tregon vetëm atë veprim që kërkohet. Në përgjithësi, shenjat detyruese përdorin një simbol të bardhë të sigurisë në një sfond të kaltër. Një shembull tipik i një shenje detyruese janë shenjat që kërkojnë përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse. Ndërkohë që ecni nëpër lokacion, tregoni vëmendje ndaj të gjitha vendeve ku duhet të vendosen shenja të tilla. Diskutoni me punëtorët se çfarë kuptimi kanë shenjat e sigurisë! Shembujt e shenjave jepen në fund të kësaj liste kontrolluese.</i>			
7.	Enët që përdoren për punime ose ruajtje të substancave dhe përzierjeve kimike, a janë të shënuar në anën e tyre të dukshme me tabela dhe/ose me			

	ngjyra të sigurisë të kuqe, dhe a janë etiketuar me piktogramet përkatëse të rrezikut, në përputhje me një rregullore specifike (CLP-GHS - nëse është e aplikueshme)? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca III, Nenet 1, 2, 5 <i>* Për të identifikuar se cilat etiketa duhet të përdoren, kontrolloni listën teknike të sigurisë të materialit kimik të substancave dhe përzierjeve kimike të përdorura/ruajtura dhe krahasoni nëse etiketat në listën teknike të sigurisë së materialit janë të njëjta si ato në enë. Nëse nuk ka listë teknike të sigurisë për materiale të substancave dhe përzierjeve kimike, kërkojini këto dokumente nga furnizuesi ose dyqani (kjo është pa pagesë).</i> <i>* Nëse ruhen sasi të mëdha të substancave ose përzierjeve të rrezikshme, shenjat dhe etiketat duhet të vendosen pranë zonës së ruajtjes ose në derën që çon në dhomën e ruajtjes. Zakonisht, vetëm ndërmarrjet që punojnë në industri me risk të lartë kanë enë që duhen etiketuar.</i> 			
8.	Gypat që përdoren për punime ose ruajtje të substancave dhe përzierjeve kimike, a janë të shënuar me tabela dhe/ose ngjyrën e sigurisë të kuqe në mënyrë të dukshme dhe në afërsi të pikave më të rrezikshme, siç janë valvulat dhe lidhëset, dhe në intervale të arsyeshme? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca III, Nenet 1,3 <i>* Kontrolloni valvulat dhe lidhëset në 2-3 pika për të parë nëse këto vende janë shënuar.</i>			

	<i>Zakonisht, vetëm ndërmarrjet që punojnë në industri me risk të lartë kanë gypa që duhen etiketuar.</i> 			
9.	A janë shënuar me tabela dhe/ose me ngjyrën e sigurisë vendet ku ekziston risku i përplasjes me pengesa? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.4 <i>* Kontrolloni në 2-3 pika ku ekziston risku i përplasjes me pengesa nëse këto vende janë shënuar. Dimensionet e shenjave duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e pengesës. Zgjedhja e ngjyrës varet nga objekti - duhet të zgjidhet ngjyra më e dukshme. Në rast se identifikoni vende me risk të përplasjes me objekte - kërkoni shkakun e tyre, mbase mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk.</i> 			
10.	A janë shënuar me tabela dhe/ose me ngjyrën e sigurisë vendet ku ekziston risku i rrëzimit? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.4 <i>* Kontrolloni në 2-3 pika ku ekziston risku i rrëzimit nëse këto vende janë shënuar. Dimensionet e shenjave duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e lokacionit të rrezikshëm. Zgjedhja e ngjyrës varet nga objekti - duhet të zgjidhet ngjyra më e dukshme.</i> 			
11.	A janë shënuar me tabela dhe/ose me ngjyrën e sigurisë vendet ku ekziston risku i rënies së objekteve? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.4			

	<i>* Kontrolloni në 2-3 pika ku ekziston risku i rënies nëse këto vende janë shënuar. Dimensionet e shenjave duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e lokacionit të rrezikshëm. Zgjedhja e ngjyrës varet nga objekti - duhet të zgjidhet ngjyra më e dukshme. Në rast se identifikoni vende me risk të rënies së objekteve - kërkonit shkakun e tyre, mbase mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk.</i> 			
12.	Rrugët e brendshme dhe të jashtme të trafikut (nëse është praktike), a janë shënuar me shirita të vazhdueshëm në një ngjyrë të qartë dhe të dukshme të sigurisë, duke marrë parasysh ngjyrën e tokës? A është e sigurt distanca mes automjeteve dhe objekteve/këmbësorëve? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.1.5, Shtojca V <i>* Kontrolloni rrugët e trafikut ku operojnë pirunarët, kamionët, traktorët etj. Zgjedhja e ngjyrës varet nga objekti - duhet të zgjidhet ngjyra më e dukshme (preferohet e bardhë ose e verdhë). Rrugët e trafikut të përhershëm dhe të ngarkuar duhet të pajisen më mirë me pengesa ose trotuare të përshtatshme (p.sh. pengesa në hyrje dhe dalje në ndërtesa). Është edhe më e sigurt nëse këmbësorët janë të ndarë nga automjetet.</i>			
13.	A janë të qarta shenjat e ndriçimit, dhe nuk shkaktojnë konfuzion? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I Nenet 5.1.2, 5.1.3 <i>* Kjo do të thotë - nuk duhet të përdoren në të njëjtën kohë dy shenja të ndriçimit që ka të ngjarë të ngatërrohen, dhe shenjat e ndriçimit nuk duhet të përdoren në afërsi të një burimi tjetër të ngjashëm të ndriçuar. Shenjat tipike të ndriçimit janë shenjat që shënojnë daljet e sigurisë.</i>			
14.	A janë të qarta shenjat akustike, dhe nuk shkaktojnë konfuzion? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I Nenet 5.1.4, 5.1.5			

	<i>* Kjo do të thotë - dy sinjale akustike nuk duhet të përdoren në të njëjtën kohë, dhe sinjalet akustike nuk duhet të përdoren nëse ka shumë zhurmë ambienti. Sinjali tipik akustik është sinjali i pirunarëve ose kamionëve që ngiten nga prapa.</i>			
15.	Kur e kërkon rasti (situata), a përdoren sinjalet me dorë dhe/ose komunikimi verbal për të udhëzuar personat që kryejnë manovra të rrezikshme? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca I, Neni 2.2 <i>* Manovra të tilla mund të jenë përdorimi i vinçave për lëvizjen e objekteve të rënda. Zakonisht, vetëm ndërmarrjet që punojnë në industri me risk të lartë përdorin sinjalet me dorë dhe komunikim verbal si shenja sigurie. Shembuj të sinjaleve me duar:</i> 			
16.	A janë të gjitha shenjat e vëzhguara me dizajn të mirë, të mjaftueshme, me pozicionim të saktë, në gjendje të mirë riparimi dhe me funksionim të saktë? Rregullore (MPMS) Nr.04/ 2016, Shtojca I, Neni 5.2 <i>* Bëni foto të shembujve të mirë dhe jo të mirë!</i>			
17.	A janë trajnuar të punësuarit për shenjat e sigurisë? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Neni 6.2, 6.3 <i>* Pyetni 2-3 të punësuar se çfarë kuptimi kanë shenjat e sigurisë në vendin e tyre të punës dhe çfarë sjellje pritet prej tyre në rast të atyre shenjave.</i>			
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				

	* Takohuni me përfaqësuesin e menaxhmentit (nëse është e mundur) dhe/ose ekspertët e SSHP-së. * Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mirë nga vizita juaj në lokacion. * Në rastet kur keni marrë përgjigjen “Jo”, sqaroheni situatën (p.sh. arsyeja për mungesën e shenjave të sigurisë), kërkonit dëshmi për çdo dokument tjetër lidhur me shenjat e sigurisë (p.sh. listën teknike të sigurisë së materialit). * Tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshillojini për obligimet e tyre në lidhje me shenjat e sigurisë, nëse është e mundur, jepni shembuj të praktikës së mirë (p.sh. organizimi i rrugëve të brendshme të trafikut).			
18.	A janë vendosur shenjat e sigurisë në përputhje me vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Neni 4.3			

SHENJAT E NDALIMIT / PROHIBITION SIGNS / ZNACI ZABRANE



Ndalohet pirja e duhanit



No smoking



Zabranjeno pušenje



Ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i
flakës së hapur



Smoking and naked flames forbidden



Zabranjeno pušenje i otvoreni plamen



Ndalohet qasja për këmbësorë



No access for pedestrians



Zabranjen pristup pešacima



Mos e shuaj me ujë



Do not extinguish with water



Ne gasiti vodom

 I papijshëm	 Not drinkable	 Nije za piće
 Ndalja qasja për të paautorizuar	 Not access for unauthorized	 Zabranjen pristup neovlašćenim licima
 Ndalohet qasja për automjete industriale	 No access for industrial vehicles	 Zabranjen pristup industrijskim vozilima
 Mos prek	 Do not touch	 Zabranjeno dodirivanje

SHENJAT PARALAJMRUESE / WARNING SIGNS / ZNACI UPOZORENJA



Material e ndezshëm ose Material
shpërthyes temperaturë e lartë



Flammable material or Explosive material
high temperature



Zapaljivi materijal ili eksplozivni materijal
visoka temperatura



Material toksik Material korroziv



Toxic material Corrosive material



Toksični materijal Korozivni materijal



Material radioaktiv Ngarkesë mbi kokë



Radioactive material Overhead load



Radioaktivni materijal Viseći teret



Automjete industriale Rrezik: Elektricitet



Industrial vehicles Danger: electricity



Industrijska vozila Opasnost: struja

 Rrezik i përgjithshëm	 Rreze laserike	 General danger	 Laser beam	 Opšta opasnost	 Laserski snop
 Material oksidues	 Rrezatim jonizues	 Oxidant material	 Non-ionizing radiation	 Oksidirajući materijal	 Nejonizujuće zračenje
 Fushë magnetike e fuqishme	 Pengesë	 Strong magnetic field	 Obstacles	 Jako magnetno polje	 Prepreke
 Rënie	 Rrezik biologjik	 Drop	 Biological risk	 Pad	 Biološki rizik

					
Temperaturë e ulët		Low temperature		Niska temperatura	
SHENJAT E DETYRUESHME / MANDATORY SIGNS / OBAVEZNI ZNAKOVI					
					
Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e syve	Duhet të mbahen helmeta e sigurisë	Eye protection must be worn	Safety helmet must be worn	Obavezno nošenje zaštite za oči	Obavezno nošenje sigurnosnog šlema
					
Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e veshëve	Duhet të mbahen pajisje për frymëmarrje	Ear protection must be worn	Respiratory equipment must be worn	Obavezno nošenje zaštite za uši	Obavezno nošenje opreme za disanje
					
Duhet të mbahen çizmet e sigurisë	Duhet të mbahen dorëzat e sigurisë	Safety boots must be worn	Safety gloves must be worn	Obavezno nošenje sigurnosnih cipela	Obavezno nošenje sigurnosnih rukavica

 Duet të mbahen kominoshet e sigurisë	 Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e fytyrës	 Safety overalls must be worn	 Face protection must be worn	 Obavezno nošenje opšte sigurnosne opreme	 Obavezno nošenje zaštite za lice
 Duhet të mbahen rripat e sigurisë	 Këmbësorët duhet ta përdorin këtë rrugë	 Safety harness must be worn	 Pedestrians must use this route	 Obavezno nošenje sigurnosnih pojaseva	 Obavezni pravac za pešake
 Shenjë e detyrimit të përgjithshëm (për tu shoqëruar me ndonjë shenjë tjetër sipas nevojës)		 General mandatory sign (to be accompanied where necessary by another sign)		 Opšti znak obaveze (po potrebi postavlja se zajedno sa dodatnim znakom)	